

VENDIM
Nr.634, datë 29.9.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZGJERIMI I VARREZAVE TË
TUFINËS, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga zgjerimi i varrezave të Tufinës, Tiranë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4 563 m² tokë/arë, me çmimin 4 000 (katër mijë) lekë/m², vlerësuar në shumën e përgjithshme 18 252 000 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale është 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, e cila do të përballohet po nga Bashkia e Tiranës.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 25.10.2007.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës.
 8. Regjistrimi i ri për Bashkinë e Tiranës i pasurisë 4 563 m² tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e vendimit.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE DHE VLERA NË LEKË SIPAS ÇERTIFIKATËS SË
PRONËSISË**

VARREZAT “TUFINË”

Sipërfaqja që do të shpronësohet është truall me nr.pasurie 26/19

Hysni Abdyl Qefalia

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Sip. M²	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit
1	Hysni Qefalia	3426	4563	4000	18,252,000	Çertifikatë

Vlera mesatare e shitjeve është llogaritur duke u bazuar në shkresën **Nr.8313/1 Prot. Dt.12.01.2007** ardhur nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Tiranë, e cila do të jetë bashkëlidhur këtyre llogaritjeve.

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3426 NR. I PASURISE 26/19 Vol. I Fq. 12/

INDEKSI I HARTES K-34-88/236-13/ SHKALLA 1:2000

ADRESA E PASURISE: Rrëhi DRENAH QF TLEDHE

Rr/L _____ P/G _____ Sb _____ K _____ Ap _____

B. KUFLIZIMET

V. 44/

L. 26/29

J. 26/20

P. 615

C. PRONARJET

HYSINI QEFALIA

D. Data: 09/2006 Ora: _____

